

Debat rreth përfshirjes së Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave

Nuk ka përgjigje se si do të përfshihej Kosova në liberalizimin e vizave

Ndërsa vendi ynë është lënë tërësisht jashtë procesit të liberalizimit të vizave për shkak se pesë shtete anëtare të BE-së vazhdojnë të refuzojnë njohjen e pavarësisë së Kosovës, ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Zenun Pajaziti, thotë se Suedia, si Presidente e radhës e BE-së për pjesën e dytë të vitit, është duke përgatitur një dokument për ta nxjerrë Kosovën nga izolimi

Adrian Çollaku

Nga fundi i këtij viti, pasi ta ketë bërë studimin e fizibilitetit për Kosovën, Bashkimi Evropian pritet që t'i ofrojë Kosovës një perspektivë për liberalizimin e vizave. Ndërsa Kosova është lënë tërësisht jashtë këtij procesi për shkak se pesë shtete anëtare të BE-së, refuzojnë njohjen e pavarësisë së Kosovës, por ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Zenun Pajaziti thotë se Suedia, si Presidente e radhës e BE-së për pjesën e dytë të vitit, është duke përgatitur një dokument për ta nxjerrë Kosovën nga izolimi.

Përfaqësues të pranisë ndërkombëtare në Kosovë dhe zyrtarë të institucioneve të vendit, kanë thënë se duhet gjetur një rrugë që Kosova të mos përjashtohet nga procesi i liberalizimit të vizave, nga i cili proces pritet të përfitojnë vendet fqinje të Kosovës.

Hrebickova: BE-ja nuk do të lejojë izolimin e Kosovës

Këto komente u bënë të hënën me rastin e debatit rreth përfshirjes së Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, të mbështetur nga "Robert Bosch Stiftung" dhe "Iniciativa Kosovare për Stabilitet", ku ndër të tjera u tha se Komisioni Evropian ka parasysh këtë çështje dhe se prapa dyerve të mbyllura do të gjendet një "masë" për të filluar me lehtësimin e vizave. Po ashtu u vlerësua se megjithëse procesi i liberalizimit të vizave është proces i gjatë, përfshirja e Kosovës në këtë proces është edhe një hap i rëndësishëm.



Zyrtarë vendorë e ndërkombëtarë diskutojnë për mënyrën e përfshirjes së Kosovës në liberalizimin e vizave

mosnjohja e Kosovës nga pesë vendet e BE vazhdon të mbetet problematike. Megjithatë, ai përmendi faktin se pasaportat e Kosovës i kanë njohur të gjitha vendet e BE-së. "Teknikisht nuk jemi larg vendeve të rajonit sa i përket liberalizimit të vizave. E dini që kohëve të fundit është përmendur shumë kjo çështje por tani më shumë se kurrë është mirë që të përmendet ky proces. Kur përmendet në Kosovë çështja e vizave, shpesh kjo temë konsumohet nga politika ditore. Kur i shtojmë kësaj faktin se jemi në vit të zgjedhjeve, atëherë është e kuptueshme se mund të ketë edhe deformime", ka thënë ai, duke shtuar se, në prag të zgjedhjeve mund të ketë deformime të

përfshirjet në këtë proces duke i evituar kundërshtinë eventuale të vendeve që nuk e kanë njohur Kosovën, nëse ndërkohë ende nuk

ka kanë njohur", tha në fund ministri Pajaziti.

A do t'u kërkojnë kosovarëve viza edhe vendet fqinje?

Ndërkaq, Verena Knaus, analiste e Iniciativës Evropiane për Stabilitet (ESI) tha se Kosovës duhet t'i ofrohet një rrugë e qartë e këtij procesi në mënyrë që edhe qytetarët të mos stimulohen të marrin pasaporta të Serbisë, shtet ky që pritet të përfshihet në liberalizimin e vizave. Sipas saj, bisedimet për liberalizimin e vizave me këtë shtet kanë filluar qysh në fillim të 2008 si lloj "stimulimi" në kohën kur pritej pavarësimi i Kosovës. Po ashtu edhe Maqedonia dhe Mali i Zi pritet të jenë ndër vendet të cilat do të përfshihen në këtë proces, ndërkaq Kosova, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina pohohet se do të mbesin jashtë përfshirjes së procesit për liberalizimin e vizave.

Ajo pohoi se Ballkanit, duke aluduar më shumë në vendet që do të mbesin jashtë procesit të lehtësimit të vizave, i thuhet se kanë perspektivë evropiane, ndërkaq në anën tjetër vështirësohet qarkullimi i qytetarëve të këtyre vendeve. "Liberalizimi i vizave për rajonin, përfshirë edhe Kosovën do të ishte edhe në interes të BE-së për shkak të sigurisë dhe kontrollit të migrimit jo ligjor", tha ajo duke shtuar se për çështjen e liberalizimit të vizave për Kosovën, shkak i mosnjohjes nga 5 vende të BE-së, Komisioni Evropian i ka duart e lidhura, megjithatë prapa dyerve të mbyllura theksoi se po veprohet.

Engjëllushë Morina, drejtore e IKS-it u shpreh të jetë më skeptike për procesin e liberalizimit të vizave. Morina pohoi se përveç procedurave për viza, shpeshherë nuk jepen arsye të mohimit të tyre dhe shpenzimit të harxhimeve që bëhen. Ajo u shpreh e shqetësuar se nëse vendet e rajonit përfshihen në liberalizimin e vizave atëherë mund të ndodh që kosovarëve edhe për këto vende t'u kërkohej viza.

Ndrryshe, Komisioni Evropian i ka ofruar Malit të Zi, Maqedonisë dhe Serbisë perspektivën e liberalizimit të vizave deri në fund të këtij viti duke e lënë Shqipërinë dhe Bosnjë e Hercegovinën të presin rastin tjetër për vitin e ardhshëm.

Ministri i Jashtëm suedez shpreh brengosjen e thellë për zhvillimin ekonomik në Kosovë

Bildt: Autoritetet e Kosovës duhet të merren më seriozisht me zhvillimin ekonomik

Karl Bildt bëri prezantimin e prioritetëve të presidencës suedeze me BE-në, e cila nis mandatin më 1 korrik të këtij viti

Ministri i Jashtëm suedez, Karl Bildt, shpreh brengosjen e thellë për zhvillimin ekonomik në Kosovë.

nga të gjitha vendet anëtare të BE-së.

proces është edhe në interes të BE-së pasi që është shqetësuese migrimi ilegal.

Ambasadorja e Çekisë në Kosovë, Janina Hrebickova, duke u shprehur optimiste, tha se rajoni në të cilën përfshihet edhe Kosova ka perspektivë evropiane. "BE dhe Presidenca Çeke në shumë raste e kanë thënë se Kosova nuk duhet të lihet mbraza kur fqinjët e saj ecin përpara. Mund t'ju siguroj se BE është e përcaktuar që të mos e lejojë të ndodhë ky izolim për Kosovën, jo vetëm për hir të Kosovës dhe jo vetëm për hir të stabilitetit dhe sigurisë në rajon, gjithashtu jo vetëm për hir të emigracionit, por edhe për hir të vlerave dhe sigurisë së BE-së", është shprehur ajo, duke shtuar se, mirëpret reformat e Qeverisë së Kosovës, në fushën e demokracisë, barazisë dhe sidomos mbrojtjes së pakicave. Sipas saj, përmbushja e kriterëve për liberalizimin e vizave varet nga Qeveria e Kosovës, ndërsa nuk mohoï se përveç kriterëve teknike për çështje të caktuara mund të ketë edhe ndikime politike. Hrebickova tha se i është dashur edhe Çekisë të vjetë deri në përmbushjen e kriterëve për regjim pa viza, mirëpo sipas saj në rastin e Kosovës duhet gjetur mënyra ndryshe nga marrëveshjet klasike për të mos e lënë anash procesit.

Ajo pohoi se Komisioni Evropian është duke hulumtuar mënyra për të ndihmuar Kosovën në këto rrethana, duke e njohur edhe të drejtën e 5 vendeve për të mos njohur shtetin e Kosovës.

Qeveria shpreson në Presidencën suedeze

Ndërsa, Zenun Pajaziti, ministër i Punëve të Brendshme ka thënë se

trajtimin të çështjes së liberalizimit të vizave, mirëpo sipas tij, teknikisht nuk janë larg vendeve të rajonit në këtë çështje.

Ai tregoi se përveç pasaportave biometrike, ka edhe kritere tjera që duhet plotësuar në gjithë këtë proces. Sipas tij, në kohën e nxjerrjes së pasaportave të Kosovës nuk ka qenë e mundur teknikisht që të lëshohen pasaportat biometrike. Sipas tij, edhe në këtë periudhë ky proces nuk mund të bëhet shpejt, mirëpo pëntenoi faktin se tashmë nxjerrja e pasaportave biometrike nuk është sfidë, mirëpo çështje teknike. Ministri sa i përket sigurisë së dokumenteve pohoi se ato janë të sigurta dhe se nuk ka evidencuar raste të falsifikimit.

"Ndër sfidat kryesore jenë sundimi i ligjit, krimi i organizuar, më të cilat sfida tekniko se përballen edhe të gjitha vendet e rajonit, duke përfshirë edhe ato vende të cilat do të kenë liberalizim të vizave", tha ai, duke vlerësuar se kriter tjetër është edhe çështja e riadhesimit që sipas tij vazhdon të jetë delikate. "Ajo çfarë na duhet neve është që të kemi një partneritet me vendet e BE-së, nënshkruajmë marrëveshje të riadhesimit, të ndalet migrimi ilegal dhe të hapet rrugë e re e migrimit legal", tha ministri, duke shtuar se, jo zyrtarisht thuhet se pas studimit të fizibilitetit për Kosovën, një ndër rekomandimet e Komisionit Evropian mund të jetë përfshirja e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave dhe kjo nëse ndodh sipas ministrit Pajaziti do të jetë tejet inkurajuese.

"Presidenca suedeze e Bashkimit Evropian presim që të propozojë një formë se si Kosova 'de facto' të

për zhvillimin ekonomik në Kosovë, nga i cili, sipas tij, varet edhe stabiliteti i vendit. Ai tërhoqi vërejtjen se autoritetet kosovare duhet të merren më seriozisht me këtë çështje, tha Bild duke prezantuar prioritetet e presidencës suedeze me BE-në.

"Kjo ishte detyrë shumë e rënde që në fillim, ndërsa tani jemi në krizë ekonomike të paprecedencë, gjë që e bën sfidën e Kosovës edhe më serioze", u shpreh Bildt, dhe shtoi se deri më tani i tërë fokusi në Kosovë kishte të bëjë me çështjet tejet të komplikuar politike.

Duke precizuar se zhvillimi ekonomik u takon para së gjithash liderëve të vendit, Karl Bildt përkujtoi se pritet një lloj ndihme edhe nga Komisioni Evropian që do zbardhet në raportin e vjeshtës.

Karl Bildt bëri prezantimin e prioritetëve të presidencës suedeze,



Karl Bildt

e cila nis mandatin më 1 korrik të këtij viti. Ai tha se nuk parasheh ndonjë komplikim shtesë në aktivitete rreth Kosovës, si pasojë e mosnjohjes nga 5 vende të Bashkimit Evropian. Më e rëndësishmja, sipas tij, është se misioni i EULEX-it po përkraket

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë rreth regjimit pa viza Jeremiq: Pasaporta edhe për të gjithë qytetarët e Kosovës

Vuk Jeremiq ka thënë se "të gjithë qytetarët e Serbisë" në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin duhet të kenë mundësi që të marrin pasaporta në qoftë se i kërkojnë, por do të aplikohen "verifikime të veçanta të sigurisë" për qytetarët nga Kosova, të cilët do të kërkojnë pasaporta, meqë "ekzistojnë rrethana të ndryshme të sigurisë"

Ministri i Punëve të Jashtme i Serbisë, Vuk Jeremiq ka thënë se pasaporta biometrike do t'u jepen edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe kjo sipas tij nuk është çështje politike, por teknike.

Jeremiq në një emision të televizionit beogradas "B92" mbi mundësitë e Serbisë që deri në fund të vitit të hiqet regjimi i vizave për

udhëtime në BE ka thënë se "asgjë s'është gati derisa të mos jetë gati", por edhe që, po të vinte bast, atëherë do të vinte bast se prej 1 janarit qytetarët e Serbisë do të udhëtojnë pa viza në BE.

Jeremiq ka thënë se "të gjithë qytetarët e Serbisë" në harmoni me Kushtetutën dhe ligjin duhet të kenë mundësi që të marrin pasaporta në qoftë se i kërkojnë, por do të aplikohen

Bildt premtoi se presidenca suedeze do të tentojë të reagojë shpejt pasi që Komisioni Evropian të dalë me rekomandime se cilave shtete të Ballkanit Perëndimor do t'iu hiqet regjimi i vizave. Ai nuk deshi të përgjigjet në pyetjen e drejtpërdrejtë nëse pret që në valën e parë të liberalizimit, pos Maqedonisë, do të futen edhe Mali i Zi dhe Serbia.

Megjithatë, shefi i diplomacisë suedeze tërhoqi vërejtjen se bëhet fjalë për një proces të pastër teknik, që bazohet ekskluzivisht në meritat e secilit shtet veç e veç.

Ndonëse Ballkani Perëndimor nuk është i përfshirë në mesin e prioritetëve kyçe të presidencës suedeze, ministri i Jashtëm Bildt tha se rrethanat në rajon bëjnë që politikanët në Bruksel të jenë gjithnjë të angazhuar. (RTK)